



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë 30/12/2020]

Bashkimit të Operatorëve ekonomik “Intelligent Network Solution” dhe “BNT Electronics” shpk

Bulevardi “Zhan D’Ark” Nd 32, Hyrja 16, kati 2 Ap.1, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 33.

Referenca e procedures: REF-76725-10-26-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti i kontratës: “Sistemi GIS për Bashkinë”

Qëllimi i kontratës është: “Sigurimi i një sistemi GIS që do ndihmojë në ndërtimin e skenarëve të cilët do të bëjnë të mundur mbledhjen, ruajtjen, analizën, përpunimin, përditësimin e informacionit geohapësinor që trajtohet nga Bashkia Tiranë si dhe rritjen e kapacitetit procesues dhe ruajtës të informacionit”

Fondi limit: 20.625.100 (njëzet milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data lidhjes së kontratës. Periudha për implementimin e sistemit më të gjithë komponentët përbërës do të jetë 6 (gjashtë) muaj nisur nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e mirëmbajtjes do të jetë 1 (një) vit nga data e marrjes në dorëzim të sistemit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 19.11.2020

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 94 datë 2 Nëntor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë-

- 1. BOE “Intelligent Network Solutions” & BNT Electronics” shpk**
NUIS 40300700694 “Intelligent Network Solutions” (shoqëri e huaj) & NUIS
BNT Electronics J61817047D

Vlera e ofertës pa TVSH– **20.250.000 (njëzet milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë**

Vlera e ofertës me tvsh–**24.300.000 (njëzet e katër milion e treqind mijë) lekë**

Nuk është s'kualifikuar asnjë operator ekonomik

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “Intelligent Network Solutions” & BNT Electronics” shpk me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark” Nd 32, Hyrja 16, kati 2 Ap.1, Tiranë, me një vlerë të përgjithshme prej 20.250.000 (njëzet milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 24.300.000 (njëzet e katër milion e treqind mijë) lekë me tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.12.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar),pranë Autoritetit Kontraktor,Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.